



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1491 Prot.

Tiranë, më 02. 10. 2019

V E N D I M

Nr. 137, Datë 02. 10. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 79 rregj., datë 08.07.2019, e shtetases L. D. kundër Zyrës Vendore Arsimore Shkodër (në vijim ZVA Shkodër), në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të bindjeve politike*¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin Bio-Kimi. Nga viti 2002 ka filluar punë si mësuese provizore në Sistemin Arsimor në shkollë të ndryshme të qytetit të Shkodrës. Pas konkurimit në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2017-2018, është renditur e dyta në Prefekturën e Shkodrës, në profilin Biologji. Në muajin dhjetor 2016, ankuesja ka filluar punë me kontratë të përkohshme në pozicionin e mësueses, pranë shkollës së mesme “Jordan Misja”. Mësuesja që ajo zëvendësoi, për arsye personale ka ndërprerë marrëdhënien e punës dhe sipas ankueses shkollë ka shpallur me datë 03.05.2017, vendin vakant. Në këto kushte, me anë të shkresës datë 06.06.2017, ka kërkuar nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, emërimin e saj në këtë pozicion. Në këtë kuptim dhe për shkak se ajo renditej e dyta në portalin “Mësues për

¹ Referuar vërtetimit datë 04.07.2019, lëshuar nga subjekti politik Partia Demokratike, Dega Shkodër, Seksioni Vukatanë

Shqipërinë” dhe kandidatja që ishte renditur e para në portal, sipas ankueses ishte emëruar në një shkollë tjetër, radha e emërimit i takonte asaj. Pavarësisht kërkesës së depozituar pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, sipas ankueses në vendin e saj është emëruar një mësuese tjetër jashtë procedurës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi. E ndodhur në këtë situatë, ankuesja i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR) me një ankesë lidhur me mohimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, për ta emëruar në pozicionin vakant në shkollën “Jordan Misja”. Sipas ankueses në përgjigje të ankesës së saj, me shkresën Nr. 8450/1 prot., datë 18.10.2017 MASR, jo vetëm që nuk ka konstatuar asnjë nga faktet e paraqitura nga ankuesja, por ka mohuar edhe shpalljen e vendit vakant në shkollën “Jordan Misja” dhe emërimin në shkollën Melgushë të kandidatit të renditur i katërti në portal.

Përsa më lart, mbështetur në informacionin e paraqitur, ankuesja i është drejtuar sërish, me shkresat e protokolluara në MASR Nr. 10144 prot., datë 02.10.2018 dhe Nr. 9571 prot., datë 18.09.2018, ku ka kërkuar zgjidhjen e situatës duke e punësuar në pozicionin e mësueses sipas përcaktimeve ligjore. Në mbështetje të kërkesave të sipërcituara, MASR me shkresën Nr. 10144/1 prot., datë 11.10.2018, ka kërkuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër të trajtohet ligjërisht kërkesa e L. D. Pavarësisht kësaj, sipas ankueses ajo vijon të mos punësohet nga ana e këtij institucioni.

Përsa më lart, ankuesja pretendon se situata e krijuar dhe mohimi për ta punësuar sipas parashikimeve ligjore, është bërë për shkak të bindjeve politike të saj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 79, datë 08.07.2019 të L. D. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo nuk i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkoi që ankuesja të vinte në dispozicion të KMD-së, argumenta apo fakte për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar. Me anë të e-mailit datë 10.07.2019, ankuesja, vuri në dispozicion, prova shkresore për të vërtetuar shkakun e bindjeve politike. Në këtë kuptim, pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, KMD filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1053/2 prot., datë 17.07.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ana e Zyres Vendore Arsimore Shkodër.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, Zyra Vendore Arsimore Shkodër, sqaroi ndër të tjera se: *“...Punësimi i të gjithë mësuesve është realizuar bazuar në ligjin nr. 69/2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar, nenin 60, pika 1, ku përcaktohet: Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’ (Jo nga DAR, siç pretendon L. D.). Procedurat e pranimit ë të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit ‘Mësues për Shqipërinë’ përcaktohen me Udhëzim të Ministrit. Udhëzimi i Ministrit përgjegjës për arsimin ishte Udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 të MAS ‘Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimin dhe largimin nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar’. Baza ligjore që është zbatuar dhe është respektuar në të gjitha rastet dhe për punësimin e L. D. Ajo ka qënë pjesëmarrëse në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’ dhe ka pasur renditje të ndryshme. Në bazë të kësaj renditjeje, L. D. është punësuar në institucione të ndryshme arsimore, me kontrata pune të përkohshme, në varësi të krijimit të këtyre vendeve si dhe radhës së saj të punësimit. Ju bëjmë me dije se, L. D. ka refuzuar të punojë në vende të lira me ngarkesë mësimore të plotë me kontratë prove një vjeçare për vitin shkollor 2018-2019, në tre institucione arsimore shkollore, konkretisht shkolla Ndreaj, shkolla Gimaj dhe në institucionin arsimore shkolla Elbace gjë e cila dëshmon respektimin e ligjit nga ana e institucioneve arsimore dhe jo diskriminim siç pretendon L. D. Punësimi i saj në shkollën ‘Jordan Misja’ në dhjetor 2016 me kontratë provizore është realizuar bazuar në kreditet e saj në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’ 2015-2016, e cila ka qënë e renditur në vendin e 5 në profilin/lëndën Kimi. Në Portalin Mësues për Shqipërinë 2016-2017, L. D. është e identifikuar:*

Kodi SH 16202, me 57.3 pikë, profili/lënda Biologji e renditur në vendin e dytë. Sa i përket pretendimeve të L. D. për vendin e punës në shkollën 'Jordan Misja', në muajin Maj 2017, shpjegojmë se drejtoria e këtij gjimnazi ka kërkuar për të mos e shpallur vend të lirë në atë moment për arsye të mungesës së ngarkesës mësimore në atë profil në vitin e ardhshëm shkollor për shkaqe të arsyeshme që lidhen me rënien e numrit të orëve të këtij profili (kurikulën e re), si dhe numrin e vogël të klasave që parashikohej nga rregjistrimet paraprake në klasën e dhjetë, kjo e shprehur edhe në njoftimin për atë vend pune. L. D. ka vijuar të punojë deri në fundin e vitit shkollor po me kontratë provizore po në atë vend pune. Në ankimimin e L. D., është pozitive që ajo pranon që ka qënë e renditur e dyta në profilin/lëndën Biologji, sepse në komunikimet, kërkesat dhe ankesat e saj, megjithëse i është bërë e qartë dhe me komunikim zyrtar ajo e ka trajtuar atë si shkelje të së drejtës si candidate e radhës e renditur e para, gjë e cila e vërteton më së miri paragjykimin dhe kërkesën jo ligjore të saj për punësim duke anashkaluar kandidaten e renditur para saj. Gjithashtu, në ankimin e saj ka të pavërteta që lidhen me kandidaten e renditur e para në profilin/lëndën Biologji që është H. D., me Kod: SH 16202, 62.5 pikë. Nuk është e vërtetë që kjo candidate ka qënë e emëruar në ndonjë shkollë tjetër në momentin që pretendon ankuesja, gjë lehtësisht e verifikueshme. Kjo shtetase rezulton e papunësuar. Në bazë të udhëzimit të sipërcituar nëse ky vend do shpallej i lirë nga drejtoria e shkollës, nëse do të plotësonite kriteret e ngarkesës mësimore do të ftohej H. D. që të punësohej në atë vend pune, në respekt të kriterëve të saj në portal dhe nuk ishte e mundur të kalohej radha për tu punësuar L. D. Gjithashtu është e pavërtetë të jetë punësuar një mësues tjetër në atë vend pune, sepse nga ngarkesa mësimore e atij vendi pune kanë mbetur vetëm orë të dhëna nga drejtoria e shkollës për plotësim orësh mësuesve të sistemit dhe për vitin shkollor që u mbyll nuk ka pasur asnjë orë të mbetur nga ajo ngarkesë mësimore për të njëjtat arsye të thëna në njoftimin e drejtorisë së shkollës për atë vend pune. Sa i përket emërimit të një mësuesi në shkollën "Shaban Banushi", Melgushë, bëjmë me dije se është mësuesi A. V., kandidat i punësuar me kontratë prove në muajin Janar 2017 me kreditet e portalit 'Mësues për Shqipërinë 2015-2016', i renditur i dyti në profilin/lëndën Biologji, në një kohë që L. D. renditej e pesta në profilin/lëndën Kimi, në portalin e po këtij viti. Si në rastin e parë dhe në rastin e dytë MASR ka ushtruar kontroll pas ankesave të L. D. dhe në të dy rastet vërtetohet veprimi ligjor i institucioneve shkollore dhe DAR Shkodër (Raport i MASR me shkresën nr. 8450/7, datë 24.10.2017). Nga konkluzioni final i këtij raporti, ka rezultuar që procedurat e ndjekura nga drejtoria e shkollës 'Jordan Misja' dhe DAR Shkodër, janë në respekt të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, nga ana e MASR është bërë verifikimi i ankesës nga grupi i punës përkatës në lidhje me ankesën nr. 2233, lidhur me verifikimin e procedurave të emërimit të mësuesit A. V., në shkollën 'Melgushë', për të cilën ka një raport nga MASR me shkresën nr. 8943/3, datë 13.10.2017, ku rezultoi që DAR Shkodër dhe drejtoria e shkollës ka vepruar në respekt të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Pretendimi i L. D. që mohimi i punësimit të saj me kontratë të përhershme për shkak të bindjeve të saj politike është vetëm zgjedhje e saj për të përlegjur ankesën tek institucioni juaj. Nuk ka asnjë moment dhe fakt që nga DAR Shkodër apo institucionet e varësisë të jetë favorizuar apo diskriminuar asnjë

individ për arsye të bindjeve të tyre politike, fetare etj. Kjo edhe për L. D., bindjet e saj i marrim vesh vetëm në këtë moment të komunikimit me institucionin tuaj, e cila pavarësisht vështirësive në komunikim dhe shantazhit të përdorur prej saj, është trajtuar brenda të gjitha rregullave duke respektuar çdo të drejtë ligjore të saj, si dhe i është ofruar mundësia për punësimin në institucionet shkollore në respekt të plotë të krediteve të saj, sipas renditjeve të portalit 'Mësues për Shqipërinë'. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se L. D., ka hapur proces gjyqësor, ku palë ë paditur është MASR dhe DAR Shkodër, me objekt: Pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ publik nr. 1449/1, datë 07.06.2017 i DAR dhe i Ministrisë së Arsimit nr. 8450/1, datë 18.10.2017. Lidhjen e kontratës 1 vjeçare të provës dhe caktimin në punë mësuese definitive për lëndën Biologji, në shkollën 'Jordan Misja', mbasi i plotësoj të gjitha kriteret ligjore etj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe ajo e Apelit Administrativ Tiranë kanë vendosur mospranimin e kërkesë padisë. Gjithashtu, L. D. ka paraqitur 2 kërkesë padi në kohë të ndryshme, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku në njërin prej rasteve është vendosur pushimi i gjykimit, ndërsa në rastin e dytë është vendosur mokuqetencë lëndore. ”.

Në mbështetje të informacionit të dhënë, ZVA Shkodër, vuri në dispozicion të KMD-së:

- Renditjen e kandidatëve pjesëmarrës në portalin “Mësues për Shqipërinë”, 2016-2017, përfshirë dhe profilin/lëndën Biologji dhe Kimi
- Renditja e kandidatëve pjesëmarrës për lëvizjen paralele 2017-2018 të profilit Biologji-Kimi
- Listën emërore të kandidatëve pjesëmarrës në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2015-2016, të profilit Biologji dhe Kimi
- Raportin e Inspektimit të MASR nr. 8450/4, datë 24.10.2017
- Dokumentacionin e komisionit të vlerësimit për lëvizjen paralele të znj. A. Sokoli.
- Dokumentacionin e emërimit të A. V. në shkollën Shaban Banushi, Melgushë
- Korrespondencën e mbajtur me L. D., ku pretendon që renditet e para si dhe me institucionet e tjera për rastin.
- Vendime gjyqësore.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ankuesja, L. D. nga viti 2002 ka filluar punë si mësuese provizore në Sistemin Arsimor në shkollën të ndryshme të qytetit të Shkodrës. Në muajin dhjetor 2016, ankuesja ka filluar punë me

kontratë të përkohshme në pozicionin e mësueses në profilin Biologji-Kimi, në shkollën e mesme “Jordan Misja”, Shkodër.

Sipas informacionit të administruar nga palët, ankuesja ka konkuruar në portalin “Mësues për Shqipërinë”, ndër vite, duke u vlerësuar si më poshtë:

- në vitin 2015-2016, ka qënë e renditur në vend të pestë në profilin, Kimi, me 55.8 pikë
- në vitin 2016-2017, ka qënë e renditur në vend të dytë në profilin Biologji, me 57.3 pikë.

Në muajin Maj 2017, mësuesja që ankuesja zëvendësonte, për arsye personale ka ndërprerë marrëdhënien e punës, duke dhënë kështu dorëheqjen nga pozicioni i punës. Në këtë moment, drejtoria e shkollës “Jordan Misja”, me anë të shkresës Nr. 98 prot., datë 03.05.2017, i është drejtuar Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër (në vijim DAR Shkodër) duke e njoftuar se: *“...pas përfundimit të procedurave për ndërprerjen e kontratës së punës me mësuesen J. Sh., vendi është i lirë. Në këtë vend, është punësuar me kontratë të përkohshme L. D.. Për arsye të ndryshimit të Kurrikulës dhe pritshmërisë së numrit të nxënësve të klasës, kjo ngarkesë mësimore për vitin shkollor 2017-2018, pritet të reduktohet, gjë për të cilën kërkojmë të vlerësohet shpallja ose jo e këtij vendi pune në këto kushte. Meqënëse është fundi i vitit shkollor, propozojmë që mësuesja aktuale të vazhdojë deri në përfundimin e këtij viti shkollor.”*

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, DAR Shkodër me anë të shkresës nr. 1058/1 prot., datë 04.05.2017, i është drejtuar Komisionit të Vlerësimit (të DAR Shkodër), duke i sqaruar ndër të tjera se: *“...njoftojmë komisionin e vlerësimit se pas propozimit të drejtorisë së shkollës ‘Jordan Misja’ vendi i lirë profili Biokimi, do të shpallet në fillim të vitit shkollor në varësi të ngarkesës mësimore për atë vend pune.”*

Me anë të shkresës³ datë 05.06.2017, ankuesja i është drejtuar DAR Shkodër dhe Drejtorisë së shkollës “Jordan Misja”, duke i parashtruar se: *“Meqë prej 7 muajsh punoj pranë kësaj shkolle si mësuese provizore dhe prej tre muajsh vendi im është shpallur vend i lirë pune dhe duke qënë fituese e vendit të parë në DAR Shkodër, në degën Biologji, në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’, paraqes kërkesën për lidhjen e kontratës 1-vjeçare të provës sipas legjislacionit në fuqi”.*

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, DAR Shkodër me anë të shkresës nr. 1449/1 prot., datë 07.06.2017, i është drejtuar ankueses, duke i sqaruar ndër të tjera se: *“...Në bazë të informacionit të marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Portalit ‘Mësues për Shqipërinë’, i vitit 2016, ju rezultoni me 57.3 pikë dhe jeni e 2-ta në renditje në profilin Biologji...Me kreditet e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’ të vitit 2017 deri më tani nuk kemi asnjë të punësuar me kontratë prove (vetëm me kontratë të përkohshme), siç jeni edhe ju, në profilin biologji dhe kimi. Çdo vend i lirë i shpallur do të plotësohet vetëm në zbatim të Udhëzimit nr. 38”.*

³ Protokolluar pranë DAR Shkodër me nr. 1449 prot., datë 06.06.2017

Në vijim, ankuesja në muajin Tetor 2017, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR), në të cilën ka vënë në dijeni lidhur me problematikën mospunësimin e saj si mësuese e profilit Biologji-Kimi nga ana e DAR Shkodër. Në përgjigje të kërkesës së ankueses, MASR, pas verifikimeve të kryera i ka kthyer përgjigje⁴, duke e sqaruar ndër të tjera se: *“...Një grup pune i ngritur nga MASR, pas verifikimit të rastit si dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të administruar nga DAR Shkodër dhe shkolla e mesme ‘Jordan Misja’, konkludoi se në muajin dhjetor 2016, ju jeni punësuar me kontratë të përkohshme si zëvendësuese në gjimnazin ‘Jordan Misja’, duke respektuar renditjen në portalin ‘Mësues për Shqipërinë’. Në mars 2017, mësuesja të cilën ju zëvendësuat, për arsye shëndetësore, ndërpret marrëdhëniet e punës në shkollën ‘Jordan Misja’. Drejtoresha e shkollës nuk ka shpallur vendin e lirë të punës për mësues Biologji-Kimi, për shkak se parashikohej rënie e numrit të orëve të këtij profili. Për klasën e XI në të cilën zbatohet kurrikula mbi bazë kompetencash, nuk zhvillohet më lënda ‘Aftësimi për jetën’, duke zbritur 8 orë më pak ngarkesë mësimore të profilit Biologji-Kimi. Gjithashtu, në planifikimin paraprak të bërë në muajin Maj për vitin shkollor 2017-2018, parashikohej rënie e numrit të nxënësve që rregjistrohen në klasën e X-të, për pasojë edhe rënie e numrit të klasave të X-ta. Aktualisht, për vitin shkollor 2017-2018, janë 7 klasa të X-ta nga 8 që ishin një vit më parë. Pra, nga totali i orëve të këtij profili ka një rënie prej rreth 14 orë gjithsej. Nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore në vitin shkollor 2017-2018, drejtorja e shkollës ka plotësuar me normë mësuesit ekzistues të shkollës dhe kanë ngelur vetëm 10 orë, të cilat mbulohen nga mësuesja e shkollës ‘28 Nëntori’, e cila është mësuese në sistem.”*

Lidhur me ankesën e L. D., mbi emërimin e një mësuesi tjetër të profilit Biologji-Kimi në shkollën “Jordan Misja”, MASR në shkresën e sipërcituar ka sqaruar se: *“...Sa i përket vendit tjetër të lirë në këtë shkollë, të mësueses së profilit Biologji-Kimi të dalë në pension, Komisioni i Vlerësimit i ngritur pranë DAR Shkodër, në muajin shtator 2017, ka kryer lëvizjen paralele të detyruar të mësueses A. S. nga shkolla 9-vjeçare ‘Gjergj Vate Martini’, Velipojë, me ngarkesë mësimore të plotë dhe të përhershme.”*

Gjithashtu nga ana e MASR, me anë të shkresës Nr. 8450/4 prot., datë 24.10.2017 i është vënë në dispozicion ankueses një kopje e Raportit të grupit të punës së MASR *“Mbi Verifikimin e Ankimit Nr. 8450, datë 12.09.2017 të znj. L. D., në lidhje me procedurat e punësimit të saj në shkollën e mesme ‘Jordan Misja’, Drejtorja Arsimore Rajonale, Shkodër”*.

Nga ana e MASR, referuar kërkesës së L. D. është ngritur sërish një grup pune për verifikimin e ankesave të saj, i cili në përfundim të procedurës ka dalë me raportin me nr. 8943/3 prot., datë 13.10.2017. Në këtë raport, i cili i është vënë në dispozicion edhe ankueses, është konstatuar ndër të tjera se: *“...Sipas listës së DAR Shkodër nr. 1932/2 prot., datë 11.09.2017 ‘Mësues për Shqipërinë’ 2016-2017 për statusin e punësimit shtator 2017, rezulton se janë emëruar gjithsej 22 mësues duke respektuar renditjen e kandidatëve, sipas pikëve totale, për çdo*

⁴ Me anë të shkresës Nr. 8450/1 prot., datë 18.10.2017

profil/lëndë...Lidhur me pretendimin e denoncuesit mbi emërimin e mësuesit në shkollën e fshatit Melgush, në janar 2017, drejtori i DAR informoi se bëhet fjalë për mësuesin A. V. Sipas dokumentacionit të administruar nga DAR Shkodër rezulton se kandidati A. V. ka konkuruar nëpërmjet portalit 'Mësues për Shqipërinë' 2015, profili Biologji dhe në listën përfundimtare është renditur i dyti, me 57.4 pikë. Më datë 16.01.2017, i njoftuar nga Komisioni i Vlerësimit të DAR Shkodër, mësuesi A. V. zgjedh të punojë në vendin e lirë në shkollën 'Sh. Banushi' Melgushë, në profilin Biologji-Kimi, me ngarkesë mësimore të plotë. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se kandidati A. V. gjendet i renditur në listën e portalit 'Mësues për Shqipërinë' 2016, edhe pse është i punësuar, sqarojmë se mësuesi ka aplikuar në portalin e vitit 2016, e cila përkon me kohën para punësimit të tij në janar 2017...Pra ky emërim është bërë përpara datës 18.03.2017, në të cilën është shpallur renditja përfundimtare e kandidatëve që kanë konkuruar nëpërmjet portalit 'Mësues për Shqipërinë' 2016. Përsa më sipër pretendimet e ngritura në denoncim nuk qëndrojnë".

Nga referim të provave të vëna në dispozicion nga ana e palëve në proces, evidentohen tre momente që duhen analizuar nga ana e Komisionerit, lidhur me trajtimin e pabarabartë nga ana e DAR Shkodër. Momenti i parë ka të bëjë me mosemërimin e ankueses në pozicionin mësueses së profilit Biologji-Kimi në shkollën e mesme "Jordan Misja". Momenti i dytë ka të bëjë me mosrespektimin e renditjes së emërimit të kandidatëve të portalit "Mësues për Shqipërinë" 2016-2017, të profilit Biologji-Kimi. Ndërsa momenti i tretë, lidhet me emërimin e një mësuesi tjetër në profilin Biologji-Kimi, në shkollën e mesme "Jordan Misja" dhe jo të ankueses.

A/1. Trajtimi i pabarabartë lidhur me mosemërimin e ankueses në pozicionin mësueses së profilit Biologji-Kimi në shkollën e mesme "Jordan Misja", gjatë vitit shkollor 2016-2017.

Në Kreun 9 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar" përcaktohet se: "1. Njësitë arsimore vendore, në bashkëpunim me drejtoritë e institucioneve arsimore publike, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen në institucionet arsimore publike. 2. Vendet e lira të punës, të krijuara në përfundim të vitit mësimor, u ofrohen në fillim mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore/ apo që kërkojnë lëvizje paralele brenda njësisë arsimore vendore. 3. Të gjitha vendet e tjera të lira të punës, apo të shpallura si të tilla gjatë vitit shkollor, trajtohen sipas përcaktimeve në këtë udhëzim. 4. Vend pune do të konsiderohet, çdo ngarkesë mësimore sipas udhëzimit përkatës, e përballueshme nga një mësues në hapësirë dhe kohë, pavarësisht nëse është në një apo disa institucione arsimore. Në rast se ngarkesa mësimore është në disa institucione arsimore, mësuesi punësohet nga drejtori i institucionit arsimor ku ka më shumë ngarkesë mësimore 5. Çdo vend i lirë pune, i paplotësuar sipas pikës 2 të këtij kreu apo i krijuar gjatë vitit mësimor, shpallet brenda dy ditëve pune në mjediset e njësisë arsimore vendore dhe të institucionit arsimor ku është vendi i lirë i punës, si dhe i njoftohet zyrtarisht Komisionit të Vlerësimit."

Bazuar në Kreun 4, të Udhëzimit të sipërcituar “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit”, pika 9, *“Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit. ...”*, specifikohet se është në tagrin e drejtuesit të institucionit të arsimit parauniversitar të bëjë emërimet në përputhje me parashikimet ligjore të përcaktuara në këtë udhëzim.

Nga analiza e provave dhe fakteve të administruara, rezultoi se pas përfundimit të procedurave për ndërprerjen e kontratës së punës me mësuesen J. Sh., të cilën zëvendësonte ankuesja në shkollën “Jordan Misja”, për arsye të ndryshimit të Kurrikulës dhe pritshmërisë së rënies së numrit të klasave dhe nxënësve, nga ana e drejtorisë së shkollës nuk është parë e arsyeshme dhe nuk është bërë shpallja e pozicionit të lirë të punës profili Biokimi, duke e shtyrë konkurimin për këtë pozicion për vitin shkollor 2017-2018. Në këtë kuptim, ankuesja vijoi marrëdhëniet e punës me shkollën “Jordan Misja”, në pozicionin e punës deri në momentin e përfundimit të vitit shkollor 2016-2017.

Përsa më sipër, nuk konstatohet se nga ana e DAR Shkodër apo drejtorisë së shkollës “Jordan Misja”, të jenë përdorur praktika të cilat vënë përpara trajtimit të pabarabartë ankuesen në raport me punonjës të tjerë.

A/2. Trajtimi i pabarabartë lidhur me mosrespektimin e renditjes së emërimit të kandidatëve të portalit “Mësues për Shqipërinë” 2016-2017, të profilit Biologji-Kimi.

Në nenin 57/4 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: *“Mësuesi i arsimit fillor dhe i arsimit të mesëm ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit pasi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale dhe të ketë kaluar provimin e shtetit, siç parashikohet në ligjin nr.10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në RSH” të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij”.*

Në Kreun 1, pika 4 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit marrin pjesë në konkurim, i cili zhvillohet në tri faza: A. Konkurrin me dosje. B. Konkurrin nëpërmjet testimit “Mësues për Shqipërinë”. C. Zgjedhja e vendit të punës”.* Ndërsa në Kreun 4 “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit” të këtij udhëzimi përcaktohet se: *“1. Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme sipas profilit/lendës është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lira të punës në institucionet arsimore. 2. Kandidati me numrin më të madh të pikëve ftohet nga komisioni dhe zgjedh një nga vendet e lira të punës (me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme), sipas preferencës së tij, në prani të drejtorëve të institucioneve arsimore ku janë vendet e lira të punës... 8. Për një vend të lirë pune me ngarkesë*

të plotë mësimore dhe të përhershme, komisioni është i detyruar të njoftojë në fillim kandidatët për mësues që janë të punësuar në një vend pune me ngarkesë të pjesshme apo të përkohshme' Mosofrimi i vendeve sipas kësaj pike bën të pavlefshme kontratën e punës të lidhur me kandidatët e tjerë. 9. Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune, ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit. Kandidati i punësuar sipas kësaj pike, nuk e humbet të drejtën për t'u njoftuar për të zgjedhur, sipas këtij kreu, si dhe ka të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të kontratës përpara afatit”.

Në Kreun 5, pika 2 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga: a) Një përfaqësues i njësisë arsimore vendore, që mbulon çështjet e kurrikulës (kryetar). b) Katër mësues me kualifikim "Mjeshtër", që përfaqësojnë katër fusha të ndryshme lëndore nga e njëjta njësi arsimore vendore (anëtarë). c) Dy përfaqësues të prindërve të zgjedhur ndërmjet kryetarëve të këshillave të prindërve (anëtarë). d) Një punonjës psiko-social nga e njëjta njësi arsimore vendore (anëtar).”*

Nga provat administruara rezulton se ankuesja gjatë konkurimit në portalin “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2015-2016, ka qenë e renditur në vend të pestë në profilin/lëndën Kimi, me 55.8 pikë, ndërsa kandidati A. V. në po të njëjtin konkurim në profilin/lëndën Biologji është renditur i dyti me pikë 57.4 pikë. Në konkurimin e kryer nga kandidatët për portalin “Mësues për Shqipërinë” 2016-2017, në profilin/lëndën Biologji, subjekti ankues konstatohet të jetë renditur e dyta, me 57.3 pikë, ndërsa kandidati A. V., është renditur i katërti me 55.4 pikë.

Në muajin Janar 2017, kur ende nuk ishte nisur procesi i konkurimit të kandidatëve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2017-2018, por ishte në fuqi renditja sipas portalit për vitin shkollor 2016-2017, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të DAR Shkodër dhe drejtorisë së shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, kandidatit A. V. i është ofruar dhe më pas lidhur kontrata e individuale e punës me afat 1-vjeçar në vendin vakant, si mësues i lëndës Bio-Kimi. Nga informacioni i administruar, Komisioni i Vlerësimit për emërimin e kandidatit A. V., në shkollën “Shaban Banushi”, Melgushë, i është referuar renditjes së kandidatëve pjesëmarrës në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2015-2016, ndërkohë që duhej të merrej për referencë renditja e kandidatëve në portalin e vitit 2016-2017. Në këtë kuptim, ankuesja duke qenë në renditje e dyta në portalin 2016-2017, me numër më të madh të pikësh se shtetasi A. V., duhet t’i ishte ofruar më parë asaj apo kandidatëve të renditur i pari apo i dyti, përpara se ti ofrohej A. V.

Përsa më sipër, referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara, arrihet në përfundimin se për tu punësuar si mësues me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme në institucionet e arsimit parauniversitar duhet të respektohen procedurat e caktuara në Udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet

arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, procedurë e cila nuk është respektuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të DAR Shkodër dhe shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, për emërimin e kryer për vendin vakant në profilin/lëndën Biologji-Kimi në rastin e emërimit të mësuesit A. V., të renditur në vendin e katërt të portalit “Mësues për Shqipërinë” 2016-2017.

Në vlerësim të dokumenteve të administruara mbi procedurat e përdorura nga DAR Shkodër dhe shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, për emërimet e punonjësve arsimor, si dhe bazuar në Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit *“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”*, Kreu 4, *“Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit”*, pika 8, *“Për një vend të lirë pune me ngarkesë të plotë mësimore dhe të përhershme, komisioni është i detyruar të njoftojë në fillim kandidatët për mësues që janë të punësuar në një vend pune me ngarkesë të pjesshme apo të përkohshme. Mosofrimi i vendeve sipas kësaj pike bën të pavlefshme kontratën e punës të lidhur me kandidatët e tjerë”* dhe pika 9, *“Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit...”*, specifikohet se është në tagrin e drejtuesit të institucionit të arsimit parauniversitar të bëjë emërimet në përputhje me parashikimet ligjore të përcaktuara në këtë udhëzim. Komisioneri vlerëson se Komisioni i Vlerësimit të DAR Shkodër dhe drejtuesi i institucionit arsimor “Shaban Banushi” janë në shkelje të procedurës së emërimit të mësuesit A. V., i cili rezulton të jetë i paligjshëm, pasi nuk janë respektuar procedurat e emërimit të mësuesve.

Përsa më sipër, referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara, arrihet në përfundimin se për tu punësuar si mësues me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme në institucionet e arsimit parauniversitar duhet të respektohen procedurat e caktuara në Udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit *“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”*, procedurë e cila nuk është respektuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të DAR Shkodër dhe shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, për emërimin e kryer për vendin vakant në profilin/lëndën Biologji-Kimi në rastin e emërimit të mësuesit A. V., të renditur në vendin e katërt të portalit “Mësues për Shqipërinë” 2016-2017.

Në vlerësim të dokumenteve të administruara mbi procedurat e përdorura nga DAR Shkodër dhe shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, për emërimet e punonjësve arsimor, Komisioneri konstaton se emërimi i shtetasit A. V. është bërë në kundërshtim me legjislacionin e arsimit, duke vënë kështu ankuesen në kushte të pafavorshme.

A/3. Në lidhje me trajtimin e pabarabartë lidhur me emërimin e një mësuesi tjetër në profilin Biologji-Kimi, në shkollën e mesme “Jordan Misja” dhe jo të ankueses.

Në Kreun 9 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit *“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet*

arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: “Identifikimi dhe shpallja e vendeve të lira të punës” të këtij udhëzimi përcaktohet se: *“1. Njësitë arsimore vendore, në bashkëpunim me drejtoritë e institucioneve arsimore publike, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen në institucionet arsimore publike. 2. Vendet e lira të punës, të krijuara në përfundim të vitit mësimor, u ofrohen në fillim mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore/ apo që kërkojnë lëvizje paralele brenda njësisë arsimore vendore. 3. Të gjitha vendet e tjera të lira të punës, apo të shpallura si të tilla gjatë vitit shkollor, trajtohen sipas përcaktimeve në këtë udhëzim. 4. Vend pune do të konsiderohet, çdo ngarkesë mësimore sipas udhëzimit përkatës, e përballeshme nga një mësues në hapësirë dhe kohë, pavarësisht nëse është në një apo disa institucione arsimore. Në rast se ngarkesa mësimore është në disa institucione arsimore, mësuesi punësohet nga drejtori i institucionit arsimor ku ka më shumë ngarkesë mësimore 5. Çdo vend i lirë pune, i paplotësuar sipas pikës 2 të këtij kreu apo i krijuar gjatë vitit mësimor, shpallet brenda dy ditëve pune në mjediset e njësisë arsimore vendore dhe të institucionit arsimor ku është vendi i lirë i punës, si dhe i njoftohet zyrtarisht Komisionit të Vlerësimit.”*

Nga analiza e provave dhe fakteve të administruara, si dhe në referim të legjislacionit të sipërcituar, rezultoi se pas daljes në pension të një prej mësueseve të profilit Biologji-Kimi në shkollën “Jordan Misja”, vendi ishte vakant. Ndërkohë, shtetësja A. S., mësuese definitive në shkollën “Gjergj Vatë Martini”, profili Biologji-Kimi, ka paraqitur pranë kësaj shkolle, kërkesën për lëvizje paralele, për shkak të ngarkesës minimale mësimore në profilin Biologji -Kimi. Referuar shkresës datë 10.05.2017, të drejtorisë së shkollës “Gjergj Vatë Martini”, konstatohet që kjo e fundit, në mbështetje të kërkesës së mësueses A. S., i është drejtuar Komisionit të Vlerësimit të DAR Shkodër, ku i ka kërkuar krijimin e mundësisë për lëvizje paralele të mësueses A. S. Në këto kushte, pas konkurimit me dosje për lëvizje paralele, ajo ka zgjedhur të punojë në vendin vakant të krijuar në shkollën “Jordan Misja”, profili Biologji-Kimi me ngarkesë të plotë dhe të përhershme.

Përsa më sipër, referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara, arrihet në përfundimin se për tu punësuar si mësues me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme në institucionet e arsimit parauniversitar duhet të respektohen procedurat e caktuara në Udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, procedurë e cila është respektuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të DAR Shkodër dhe shkollës “Jordan Misja”, për emërimin e kryer për vendin vakant në profilin/lëndën Biologji-Kimi në rastin e emërimit të mësueses A. S. Në këtë kuptim dhe në mbështetje të parashikimeve⁵ ligjore, duke qënë se vendet e lira të punës, të krijuara në përfundim të vitit mësimor, u ofrohen në fillim mësuesve që mbeten pa ngarkesë

⁵ Pika 2 e Kreut 9, të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”

mësimore/ apo që kërkojnë lëvizje paralele brenda njësisë arsimore vendore, pozicioni vakant i mësueses në shkollën “Jordan Misja” i është ofruar A. S. dhe jo ankueses. Pra, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe pafavorshëm, krahasuar me shtetasen A. S.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁶ të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me standartin ligjor, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e DAR Shkodër për shkak të *bindjeve politike*, shkak i parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

“*Bindja Politike*” është shkak, për të cilin Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri vlerëson se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Bazuar në provat e administruara, subjekti ankues

⁶ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

mbart shkakun e bindjes politike pasi ka depozituar pranë KMD-së vërtetimin datë 04.07.2019, lëshuar nga subjekti politik Partia Demokratike, Dega Shkodër, Seksioni Vukatanë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e DAR Shkodër dhe Drejtorisë së Shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁷, për të cilat ankuesja pretendon diskriminim dhe trajtimit të padrejtë të saj.

Sipas të dhënave⁸, referuar lajmeve të publikuara në media më datë 29.08.2019, nga media on-line Shqiptarja.com, ndër të tjera shkruhet se: “...Dje në mbledhjen me drejtorët politikë të qarkut të Shkodrës Rama urdhëroi që të gjithë burrat të japin dorëheqjen ndërsa për disa nga gratë do të rishikohet pozicioni...”. Gjithashtu në vijim të lajmit citohet se lista e drejtorëve të cilët kanë dhënë dorëheqjen, ku vërehet se një prej tyre është shtetasi K. Y. - Drejtor i DAR Shkodër.

Gjithashtu, media on-line Opinion.al, më datë 29.08.2019, ka publikuar lajmin⁹: “Një ditë pas urdhërit të Ramës, dorëhiqen disa prej drejtorëve në Shkodër”, ku në brendësi të tij citohet se: “Një ditë pas urdhërit të kreut të qeverisë, Edi Rama, disa nga drejtorët e insitucioneve më të rëndësishme në Shkodër kanë dhënë dorëheqjen. Mësohet se ka paraqitur dorëheqjen, K. Y. në postin e Drejtorit të DAR...Kujtojmë se kyeministri Edi Rama ka zhvilluar ditën e djeshme një takim me drejtorët politikë të qarkut të Shkodrës ku është diskutuar lidhur me emërimet dhe shkarkimet në strukturat e PS në këtë qark. Rama ka deklaruar se të gjithë burrat duhet të japin dorëheqjen ndërsa për nga disa nga gratë do të rishikohet pozicioni. Kreu i qeverisë është shprehur se këto ndryshime nuk bëhen për shkaqe personale por bëhen për të krijuar një imazh të ri të PS në Shkodër”.

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar ne nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : “Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim ”, nuk lind nevoja për verifikim.

⁷ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁸ <https://shqiptarja.com/lajm/urdhri-i-rames-japin-doreheqjen-shtate-drejto-re-ne-shkoder-emrat>

⁹ <https://opinion.al/nje-dite-pas-urdherit-te-rames-dorehiqen-disa-prej-drejto-reve-ne-shkoder/>

Komisioneri vlerëson se nga ana e DAR Shkodër nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankueses se mos ofrimi i pozicionit të mësueses së lëndës së Biologji-Kimisë në shkollën “Shaban Banushi”, Melgushë, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së saj politike.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast DAR Shkodër. Pra, në këtë rast DAR Shkodër, duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Duke iu referuar çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkarkimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja¹⁰ është shprehur se: *“...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkarkimin e punonjësit për shkak të anëtarësimit të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm.”*. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës¹¹.

Po ashtu, në “Kartën Sociale Europiane” të rishikuar¹², dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, germa d) parashikohet se: *“...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:... d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare, përgjegjësitë familjare, shtatzania, besimi fetar, **opinionit politik**, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”*.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*.

¹⁰ Shkurtesë për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

¹¹ “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”.

¹² “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹³. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Nga ana e DAR Shkodër nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlijnin faktin se procedura e ndjekur për emërimin e mësuesit të Biologji-Kimisë në shkollën “Shaban Banushi”, Melgushë ka ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se L. D., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e DAR Shkodër, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankueses.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, 7/1, 12, 13 nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetas L. D., nga ana e Drejtorisë së Arsimore Rajonale Shkodër (aktualisht Zyra Vendore Arsimore Shkodër), për shkak të bindjes politike,

¹³ Referuar nenit 3, pika 8 ,e LMD-së.

lidhur me procedurën e emërimit të mësuesit të lëndës Biologji-Kimisë në shkollën “Shaban Banushi”, Melgushë.

2. Në referim të pikës 1, Zyra Vendore Arsimore Shkodër, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, në zbatim të pikës 8, të Kreut 4 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “*Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar*”, të marrë masat e menjëhershme për shpalljen e pavlefshme të kontratës së lidhur në shkelje të kësaj dispozite me shtetasin A. V.
3. Në referim të pikës 1, Zyra Vendore Arsimore Shkodër, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë emërimin e L. D. me ngarkesë të plotë mësimore dhe të përhershme.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Zyra Vendore Arsimore Shkodër, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)